



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 6825
Data: 22.08.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË FSHATIN GORANCË PËR DRAFT
BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i pestë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **12.08.2025**, duke filluar nga ora **19:00** në SHFMU “**Veli Ballazhi**”, në fshatin Gorancë, me gjithsej 14 pjesëmarrës/e, prej tyre 2 gra dhe 12 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z. Sevdin Dernjani**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj. Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z. Sevdin Dernjani**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Sevdin Dernjani thekson: Jemi në dëgjimin e radhës buxhetor dhe këtë herë në fshatin Gorancë, për të diskutuar mbi ndarjet buxhetore të Komunës për vitin 2026 dhe parashikimet e hershme për vitet 2027-2028. Në pika të shkurta, buxheti i komunës përbëhet nga disa burime të fianncimit: granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit, granti specifik i shëndetësisë, të hyrat vetanake. Buxheti total komunal për vitin 2026 do të jetë 4.2 milion euro, prej të cilave rreth 868 mijë do të jenë për investime kapitale. Kjo shumë nuk është e mjaftueshme për t’i mbuluar të gjitha kërkesat dhe nevojat tuaja, mirëpo ne do të mundohemi që të bëjmë ndarje të drejtë dhe të barabarta, në veçanti për projektet që janë më prioritare për banorët. Fjalën ia jap drejtoreshës së financave, e cila do ta elaborojë më mirë buxhetin e planifikuar.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor në fshatin Gorancë

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra këtë shumë ne mund ta shpenzojmë

për projekte të ndryshme kapitale, ku para vetes keni fletushkat e përgatitura nga Instituti GAP, të cilën janë të listuara projektet kapitale, ku ka projekte që barten vit pas viti, por edhe projekte tjera të propozuara nga qytetarët. Si e tha edhe nënkryetari, buxheti komunal mund të mos jetë i mjaftueshëm për të gjitha kërkesat tuaja, mirëpo nëse keni ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i dëgjuar, për të cilat do të mbajmë procesverbal, do t'i evidentojmë, do të hartojmë raportin e dëgjimeve dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit. Dhe hapi i fundit është dërgimi i tij në Kuvend Komunal për miratim, e ku kemi afat deri me 30 shtator për ta miratuar.

2. Diskutimi

Sevdi Dernjani: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

Shefket Lusnjani: Unë ju falënderoj për ardhjen tuaj, si dhe për buxhetin e planifikuar. Megjithatë unë si administrator bashkë me banorët dhe këshillin e fshatit dhe të xhamisë, kemi mbledhur në një listë të gjitha kërkesat që mendojmë se janë më me prioritet për t'i realizuar. Këto projekte do t'i prezantojë z. Nusret Kaloshi, kryetar i këshillit të xhamisë.

Nusret Kaloshi: Në emër të kryesisë së fshatit, unë do t'i lexoj një nga një projektet që ne si banorë mendojmë se janë më me prioritet:

1. Rregullimi i rrugës "ByPass (Fushë - Varreza)
2. Rregullimi i rrugës që çon te lapidari i dëshmorëve "Feriz dhe Xhevdet Guri", duke fillu nga vorret deri te lapidari, uji, Mulla Osmani
3. Shtrimi me kubëza betoni tek Varrezat , si dhe rrethoja e varrezave të fshatit Rezhancë
4. Tensioni i lartë lidhja prej fabrikës, arsyeja pronat private dhe shtëpitë, gjithashtu bartja e shpenzimeve të pompës së rrumës në Sudonec.
5. Uji prej Shtraze, kaptazha ju takon banorëve ndërsa rrjeti ju takon komunës.
6. Kërkesat nga këshilli i fshatit janë pa realizu, faturat me shuma 1000 € dhe 500 €
7. Vendosija e shportave të mbeturinave
8. Kapakët e shakteve prej vorreve nëpër fshat dhe kanalizimi deri tefshati Rezhancë, madhësia e kapakëve është e ndryshme, ky është projekt prej vitit 2022 që e kërkojmë
9. Rregullimi i asflatit dhe vendosja e pengesave të shtrira në rrugë nëpër fshat.
10. Rregullimi i shëtitores Gorancë – Pisha – Hunel, ku të bëhet rregullimi me kubëza betoni, vendosja e ndriçimit publik, ulëseve dhe shtegu për biçiklist.
11. Mirëmbajtja e hapësirës tek AMF – Gorancë, pjesa e parkut dhe oborrit, si dhe parkut të pishave.
12. Tek rruga "Pavarësia" të bëhet zëvendësimi i shtyllave të drurit me atë të betoni, si dhe rrjeti 500-800 m kabull, ndërsa ka nevojë për rreth 15-20 shtylla.
13. Asfaltimi i rrugës Hune – parku te Pishat.
14. Rruga Gorancë – Pustenik të asfaltohet që ta kemi më lehtë vizitën tek varrezat e dëshmorëve.
15. Të bëhet përforcimi i rrjetit të telefonisë mobile, Vala apo Ipko.
16. Rregullimi i rrugës dhe pishinës përtek Gjurët, ku të bëhet hapësirë rekreative për fëmijët.
17. Të mundësohet transport publik edhe për në fshatin Gorancë.

Sevdi Dernjani: Lidhur me këto projekti, nga sa munda me mabjt mend dhe me i shënu. Te projekti i rrugës së ByPass-it, ne prej fillimit kemi thanë që ajo rrugë mjafton që me us jellë nënshkrimit e krejt banorëve që e lëshojnë pronën për rrugë, mirëpo e dini edhe ju se ne kemi bërë përpjekje, por një gjë e tillë nuk ak ndodh deri sot, disa prej banorëve nuk e kanë vullnetin. Ndërsa ne si komunë e kemi të pamundur me vazhdu me shpronësim sepse nuk kemi buxhet. Te rruga që çon te pllaka e dëshmorëve Feriz e Xhevdet Guri, ne disa herë e kemi rrafshu atë rrugë, e kemi pastru, e kemi shtru me shtresë që së paku në përvjetor me pas qysh em kalu, pse jo në të ardhmen me u kry edhe kjo kërkesë. Te shtrimi me kubëza betoni, komuna e ka si projekt në vazhdimësi, do të thotë se edhe ky projekt në buxhet përfshihet, vetëm se ajo është% për shumë zona e besoj se edhe kjo ku ju e kërkon, mundet me u realizu. Tek tensioni i lartë dhe çështjet që lidhen me rrymën, ne kemi bërë përpjekje vazhdimisht që kërkesat e banorëve që idhen me shtrimin e rrjetit të KEDS me i bo si kërkesa zyrtare dhe me i përcjell në KEDS, ne sa i përket kërkesës tuaj, mundemi me e orientu kërkesën në KEDS. Te shportat e mbeturinave, ky projekt hyn me shërbime publike, nuk përfshihet te projektet kapitale, edhe si e tillë ka kosto më të vogël dhe nuk do të ishte problem me u realizu. E njëjta vlen edhe për kapakët e shaktave dhe pengesat e shtrira në rrugë. Te shtrimi ndriçimi publik, komuna veçse e ka në procedura tenderimi projektin për shtrirje dhe mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit, dhe duhn evidentu të gjitha pikat ku ju keni kërkesa, me i shqyrtu dhe mandej me vepru. Rrugën prej Gorancës në Pustenic është projekt që e keni kërku edhe më herët, dhe besoj se një nga mënyrët është duek gjentur donatorë apo bashkëfinancues që ajo rrugë me u hap si trase e më pas edhe me u asfaltu. Gjtiastu edhe për rrjetin e telefonis Vala dhe Ipko ne mundemi me i orientu si kërkesa tek këto operatorë, ndashta si institucion zyrtar mund t'i marrin më seriozisht kërkesat. Gjtihsesi, ne kemi shënaur të gjitha projektet tuaja që i keni kërku në këtë dëgjim buxhetor, do t'i shqyrtojmë më pas do të përpilohet draft buxheti i vitit 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 19:40.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

Nënkryetari i Komunës
Sevdi Dernjani

